

MBI 9 MIJË ANKESA NË ILD, PËR 75 % KA VENDIMMARRJE

Faqe 2

Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligj, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka paraqitur në fund të muajit prill pranë Kuvendit të Shqipërisë Raportin Vjetor të Veprimtarisë për vitin 2025. Raporti, i publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit, www.ild.al, paraqet në mënyrë të detajuar veprimtarinë e ushtruar gjatë periudhës njëvjeçare të raportimit, duke përfshirë statistika dhe tregues mbi punën e kryer nga institucioni.



ILD në shifra

135 vendime nga 265 praktika të trajtuara:
122 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar
13 vendime arkivimi pas verifikimit

72 vendime verifikimi

Qytetari në Zyrën e ILD-së

Gjatë muajit Maj 2026:

- Janë pritur **26 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Janë realizuar **20 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës;
- Janë trajtuar **20 kërkesa** për informacion.



Vizitë pune e ILD në Danimarkë për bashkëpunimin në drejtësi

Fq. 3-5



Fjala e Zv. Inspektorese së Lartë të Drejtësisë, Znj. Elena Pelushi, në aktivitetin për ditën e drejtësisë, në gjykatën e Fierit

Fq. 6-7



Inspektori i Lartë i Drejtësisë takon shoqatën e Prokurorëve

Fq. 8-9

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, takim me studentë të Universitetit të Tiranës

Fq. 13-15

Inspektori i Lartë i Drejtësisë takon studentët e angazhuar në nismën "Forumlex"

Fq. 16-17

Inspektori i Lartë i Drejtësisë mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të RESIJ në Madrid

Fq. 18-19

MBI 9 MIJË ANKESA NË ILD, PËR 75 % KA VENDIMMARRJE



Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligj, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka paraqitur në fund të muajit prill pranë Kuvendit të Shqipërisë Raportin Vjetor të Veprimtarisë për vitin 2025. Raporti, i publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit, www.ild.al, paraqet në mënyrë të detajuar veprimtarinë e ushtruar gjatë periudhës njëvjeçare të raportimit, duke përfshirë statistika dhe tregues mbi punën e kryer nga institucioni.

Që prej nisjes së funksionimit e deri në publikimin e këtij buletini, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë konfirmuar 9214 ankesa nga qytetarë dhe institucione të ndryshme dhe janë trajtuar 6907 prej tyre. Vetëm gjatë vitit 2025 ka një rritje të ndejshme të ankesave të mbërritura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, më konkretisht janë depozituar 1792 ankesa të reja, 1718 nga persona fizikë dhe 74 ankesa nga persona juridikë. Ky trend progresiv, në krahasim me vitin paraardhës, dëshmon rritjen e besimit të publikut tek roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në kohë të ndryshme e në mënyrë sistematike, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u ka dhënë përgjigje qytetarëve rreth pyetjeve që kanë patur mbi ankesën e tyre, vendimmarrjen, kohën e shqyrtimit të ankesës, ndaj kujt nuk duhet bërë ankesë, apo edhe arsyen e arkivimit të ankesës.

Bazuar në procesin e shqyrtimit të ankesave, sjellim në vëmendje se siç është e parashikuar në ligj, ILD nuk është kompetente për të shqyrtuar ankesat ndaj kancelarëve, ndihmësve ligjorë, kryesekretarit të gjykatës, sekretarëve gjyqësorë, ftuesve, nëpunësve të tjerë të administratës gjyqësore, oficerëve të Policisë Gjyqësore, avokatëve apo përmbaruesve shtetërorë ose privatë, apo subjekte të tjera që marrin pjesë në një proces hetimor apo gjyqësor. Sikurse nuk është kompetente për ankesa që lidhen me institucione të tjerë të Administratës Publike. Vetëm për vitin 2025 janë evidentuar 1635 ankesa të trajtuara, 12 hetime disiplinore të filluara, 23 hetime të përfunduara për 25 magjistratë, si dhe 16 raste të referuara për vlerësime etiko-profesionale në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Lidhur me procedimet disiplinore janë 8 procedime, për të cilat Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar masa disiplinore sipas parashikimeve ligjore për magjistratët prokurorë dhe gjyqtarë, pa lënë pas edhe 7 inspektive tematike të përfunduara. Gjatë trajtimit të ankesave, në harkun e një viti janë regjistruar 166 vendime për verifikimin e ankesave.

VIZITË PUNE E ILD NË DANIMARKË PËR BASHKËPUNIMIN NË DREJTËSI



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani, zhvilloi një vizitë pune në Danimarkë, më 21 dhe 22 maj 2026, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e drejtësisë dhe mekanizmave të përgjegjshmërisë së magjistratëve.

Në Kopenhagë, delegacioni i ILD-së zhvilloi takime me përfaqësues të institucioneve daneze dhe të Ambasadës së Shqipërisë.

Në takimin me Drejtorin për Politikë Evropiane në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës, Jakob K. Alvi, u diskutua mbi ecurinë e reformës në drejtësi, standardet e shtetit të së drejtës dhe proceset integruese të Shqipërisë.

Gjatë bashkëbisedimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani vlerësoi mbështetjen daneze dhe theksoi se reforma në drejtësi në Shqipëri ka konsoliduar parimet e shtetit të së drejtës dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor gjatë dekadës së fundit. Ai nënvizoi se ILD ushtron funksionet e veta në përputhje me parimin e përgjegjësisë disiplinore, duke ruajtur njëkohësisht ekuilibrin e domosdoshëm mes pavarësisë funksionale të magjistratëve dhe së drejtës së qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie në administrimin e drejtësisë.

Në takim u diskutua edhe bashkëpunimi rajonal i ILD-së. Metani evidentoi anëtarësimin e institucionit në rrjetin evropian RESIJ dhe organizimin në Tiranë të konferencës rajonale të shërbimeve të inspektimit me vendet e Ballkanit Perëndimor, si një nismë që do të vijojë më tej.

Nga ana e tij, Jakob K. Alvi vlerësoi punën dhe zhvillimin institucional të ILD-së, ndërsa bëri me dije se Danimarka do të rihapë ambasadën e saj në Shqipëri në muajt e ardhshëm.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi gjithashtu një takim në Gjykatën Speciale për Ngritjen e Akuzës dhe Rishikimin, ku u prit nga kryetarja e kësaj gjykate dhe njëkohësisht gjyqtare e Gjykatës së Lartë, znj. Hanne Schmidt, zëvendëskryetari, gjyqtari i Gjykatës së Lartë z. Jens Kruse Mikkelsen, si dhe z. Christian Dam Nielsen, gjyqtar i deleguar në Gjykatën e Lartë dhe drejtor ligjor në Sekretariatit e Gjykatës Speciale për Ngritjen e Akuzës dhe Rishikimin.

Gjatë takimit u diskutuan mekanizmat danezë të inspektimit dhe përgjegjshmërisë në sistemin e drejtësisë, si dhe praktikat për trajtimin e çështjeve disiplinore dhe garantimin e standardeve profesionale.

Delegacioni i ILD-së zhvilloi gjithashtu një takim në Ambasadën e Shqipërisë në Kopenhagë me Ambasadorin Sokol Dedja, ku u diskutua roli i ambasadës në forcimin e marrëdhënieve me vendin pritës dhe në mbështetjen e bashkëpunimit me diasporën shqiptare, si dhe rëndësia e saj si urë lidhëse midis institucioneve shqiptare dhe komunitetit shqiptar jashtë vendit.

Vizita shërbeu për thellimin e dialogut institucional dhe njohjen me përvojën daneze në funksionimin e institucioneve të drejtësisë dhe standardet e shtetit të së drejtës.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
BULETINI MUJOR





FJALA E ZV. INSPEKTORES SË LARTË TË DREJTËSISË, ZNJ. ELENA PELUSHI, NË AKTIVITETIN PËR DITËN E DREJTËSISË, NË GJYKATËN E FIERIT



I nderuar z. Kryetar!

Të nderuar magjistratë, profesorë të të drejtës, dhe të ftuar,

Ju faleminderit z. Veizi, për këtë organizim në kremtim të Ditës së Drejtësisë!

Kjo është një ditë simbol për drejtësinë dhe shtetin e së drejtës në Shqipëri dhe si e tillë, kremtimi i saj së bashku me ju, magjistratë, profesorë të të drejtës dhe bashkëpunëtorë me kontribute në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, e bën edhe më domethënëse.

Kujtimi i kësaj dite është në vetvete një reflektim për drejtësinë, si një gur themeli i çdo shoqërie demokratike. Ajo mbështetet në parime themelore si barazia, paanshmëria, transparenca dhe pavarësia. Duke garantuar drejtësinë dhe duke mbrojtur të drejtat e çdo individi, drejtësia kontribuon në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të ekuilibruar.

Kujtimi i kësaj dite është një reflektim për rrugëtimin e drejtësisë sot dhe nesër në Shqipëri, për raportin që drejtësia ka me shoqërinë dhe institucionet e saj.

Besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është një ideal për t'u ruajtur. Në çështjen Gudmundur Andri Astradsson kundër Islandës^[1], Gjykata është shprehur se: "283 Gjykata ka theksuar vazhdimisht rolin e veçantë që luan gjyqësori në shoqëri: si garant i drejtësisë, një vlerë themelore në një shtet të qeverisur nga sundimi i ligjit, ai duhet të gëzojë besimin e të gjithëve në mënyrë që të kryejë misionin e tij në mënyrë efektive".

Misioni i magjistratëve, si mbrojtës të të drejtave individuale dhe lirive themelore, e tejkalon gjykimin e thjeshtë të një mosmarrëveshjeje dhe çdo paragjykim në vendimet e tyre e dobëson këtë mbrojtje, duke minuar besimin e publikut në angazhimin e sistemit gjyqësor për drejtësi

Në këtë drejtim, ajo që vlerësohet e nevojshme është respekti për vendimet përfundimtare. Ky respekt do të ekzistojë vetëm kur sistemi i drejtësisë të tregojë pavarësi, paanshmëri, vëmendje të mjaftueshme dhe humanizëm, si dhe do të duhet të ketë një reagim në mënyrë efikase, të shpejtë dhe të përshtatshme, të arritshme për të gjithë. Vonesat e pajustificuara dhe të panevojshme në një procedurë janë në kundërshtim si me idealin, ashtu edhe me shpirtin e drejtësisë.

Roli i ILD-së nuk duhet parë thjesht në dimensionin ndëshkues disiplinor, por në një prizëm më të gjerë edukues dhe parandalues, në funksion të krijimit të një kulture të lartë etike dhe profesionale në pushtetin gjyqësor. Në këtë mënyrë, ky institucion po angazhohet të shndërrohet në një mbështetës të vërtetë të parimeve të shtetit të së drejtës, duke ruajtur ekuilibrin e ndjeshëm mes llogaridhënies dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

Pavarësia e magjistratëve nuk është një privilegj i dhënë për përfitimin e tyre personal, por u garantohet atyre, në interes të atyre që kërkojnë drejtësi. Nuk bëhet fjalë për mbrojtjen e tyre (magjistratëve), por për sigurimin e besueshmërisë së sistemit të drejtësisë. Minimi i saj do të dobësonte autoritetin e shtetit dhe do të komprometonte një nga funksionet e saj thelbësore. Pavarësia është e nevojshme për të ruajtur besimin e publikut në paanshmërinë e administrimit të drejtësisë, pasi është kushti thelbësor për respektimin dhe pranimin e vendimeve gjyqësore nga ata që kërkojnë drejtësi.

Ju faleminderit!

[1] 1 dhjetor 2020, nr. 26374/18, GJEDNJ



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKON SHOQATËN E PROKURORËVE



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani, i shoqërar nga Zëvendësinspektorja e Lartë e Drejtësisë Elena Pelushi, priti në takim një përfaqësi të Shoqatës së Prokurorëve të Shqipërisë, të kryesuar nga prokurori Gëzim Spahiu.

Z. Spahiu e njohu Inspektorin e Lartë të Drejtësisë me objektivat e shoqatës së krijuar në dhjetor 2025, me synimin për të ofruar një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, e cila do të shërbejë si një pikë referimi për zhvillimet e rëndësishme, problematikat dhe çështjet që lidhen me statusin dhe funksionin e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Në takim u nënvizua rëndësia e pavarësisë së prokurorëve si shtyllë themelore e sundimit të ligjit dhe qeverisjes demokratike. U nënvizua se prokurorët duhet të ushtrojnë detyrat e tyre të lirë nga ndikimet e paligjshme, duke respektuar plotësisht Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, pasi një prokuror i pavarur forcon besimin e qytetarëve tek drejtësia dhe tek barazia para ligjit.

Njëkohësisht, diskutimi vuri në pah se pavarësia duhet të shkojë paralelisht me përgjegjësinë, profesionalizmin, integritetin dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve dhe institucioneve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani vuri në dukje se balanca ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies është thelbësore. *“Prokurorët duhet të jenë të mbrojtur nga ndërhyrjet e padrejta, por njëkohësisht të mbajnë përgjegjësi për shkeljet profesionale ose etike. Vetëm përmes këtij ekuilibri mund të ndërtohet një sistem drejtësie i besueshëm, transparent dhe në shërbim të interesit publik.”*

Gjatë bashkëbisedimit, vëmendje e veçantë iu kushtua gjithashtu rëndësisë së ruajtjes dhe rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Të dyja palët ranë dakord se besimi i publikut forcohet përmes hetimeve të paanshme, zbatimit të qëndrueshëm të ligjit, transparencës institucionale dhe komunikimit efektiv me publikun.

Bashkëbiseduesit u angazhuan për të vazhduar dialogun konstruktiv dhe bashkëpunimin për çështje që kontribuojnë në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe avancimin e interesit publik.



MAJI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Maj 2026** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **102 ankesa** të cilat janë **depozituar nga qytetarë**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit Prill 2026.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME
<p>135 vendime nga 265 praktika të trajtuara:</p> <ul style="list-style-type: none">· 122 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar· 13 vendime arkivimi pas verifikimit	<p>72 vendime verifikimi</p>

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankese, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.



Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217. Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Prill 2026**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **11 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikua prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinorit për të drejtën e informimit elis.kuci@ild.al

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

*Gjatë muajit **Maj 2026**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **20 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, TAKIM ME STUDENTË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS



Në kuadër të 10 Majit, ditës kombëtare të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani mikpriti në institucion një grup studentësh të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës me të cilat ndau pikëpamje për reformën në drejtësi, pritshmëritë e publikut, si dhe objektin e veprimtarisë të institucionit që drejton.

I shoqëruar nga këshilltarja magjistrate Arjeta Lika, ndihmësinpektori Julis Zebi, përgjegjësi i sektorit të ndihmës dhe koordinimit të informacionit Elis Kuçi dhe specialistja e marrëdhënieve me publikun Zilije Feçi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani iu përgjigj interesit të studentëve edhe mbi zbatimin e Reformës në Drejtësi. Ai theksoi se 10 vite më pas, mund të konstatohet se Reforma në Drejtësi ka kontribuar në krijimin e një sistemi, ku asnjë pushtet nuk mund të jetë abuzues. Gjithashtu, zoti Metani shtoi, se legjislacioni ka garantuar më shumë pavarësi për magjistratët, por njëkohësisht ka forcuar mekanizmat e kontrollit dhe të llogaridhënies së tyre. *“Natyrisht nuk jemi ende aty ku duhet, por kushtetuta dhe ligji sot nuk krijojnë asnjë mundësi, që institucionet në procesin e vendimmarrjes së tyre të kenë ndikim të paligjshëm, politik apo çdo lloj tjetër”* – tha z. Metani.

Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë *“Kjo pavarësi e garantuar me ligj për çdo gjyqtar e prokuror është një fuqi e madhe për të ndikuar në zhvillimin e shoqërisë e konsolidimin e shtetit të së drejtës, ku dhënia e drejtësisë nuk konsiderohet privilegj apo rastësi, por detyrim dhe e drejtë e çdo individi”*. Duke vijuar më tej, z. Metani shtoi se *“pavarësia që i jep Kushtetuta gjyqtarit, në fakt nuk është një pavarësi që i jepet atij, por si përfitim për qytetarin e të drejtën që i takon”*.

Në përgjigje të interesimit për funksionimin e ILD-së, zoti Metani u shpjegoi të rinjve konceptin e ndarjes së pushteteve, pavarësinë e tyre dhe rolin e ILD-së mes tre pushteteve, ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit,

ndërsa shtoi se Kushtetuta e ka parashikuar ILD-në, si një mekanizëm për të kontrolluar dhe mbikëqyrur punën e gjyqësorit, sa i takon shkeljeve apo abuzimeve, por pa cenuar pavarësinë e tyre në vendimmarrje.

Zoti Metani vuri në dukje se *“vendimmarrjen e një magjistrati e kontrollon vetëm një gjykatë e një shkallë më të lartë. Edhe nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë konstaton shkelje procedurale, që sjellin pasojë, heton dhe procedon magjistratin. Edhe nëse shkarkohet ai, kjo nuk prek vendimin gjyqësor”*.

Gjatë bashkëbisedimit me studentët, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u ndal edhe tek inspektimet, të cilat monitorojnë fenomene të caktuara në gjykata e prokurori, si zvarritjet në zbardhjen e vendimeve gjyqësore për shembull, duke verifikuar afatet, respektimin apo shkeljen e tyre, e duke përgatitur një raport në përfundim me rekomandimet përkatëse, të cilat nëse janë të karakterit ligjor i dërgohen si propozime Ministrisë së Drejtësisë, e në raste të tjera lihen propozime, që i dërgohen Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, gjetja e balancës mes ngarkesës dhe neglizhencës së magjistratëve është një pikë, që nuk kërkon vendimmarrje emocionale, por një analizë të plotë.

Në fund të fjalës së tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ftoi studentët të bëhen pjesë në intershipë, për të parë nga afër punën që bëhet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Interesimi i studentëve vijoi mbi llojet e shkeljeve të magjistratëve, afatet e trajtimit të ankesave dhe arsyet e arkivimit të tyre, si dhe mbi vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD). Gjithashtu u trajtua çështja e mënyrës së fillimit të hetimit nga ILD, nëse ai nis vetëm mbi bazën e një anese apo edhe me iniciativë. Për këto pyetje u dhanë përgjigje nga magjistratja Arjeta Lika dhe ndihmësinpektori Julis Zebi.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
BULETINI MUJOR





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKON STUDENTËT E ANGAZHUAR NË NISMËN "FORUMLEX"




Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një takim informues me një grup studentësh të degës së drejtësisë, të angazhuar në nismën "ForumLex", në kuadër të programit për informimin dhe edukimin ligjor të publikut. Duke u bërë një paraqitje të kompetencave të institucionit e në kuadër të kurrikulës së tyre mbi lëndën e të drejtës kushtetuese, zoti Metani u shpjegoi të rinjve konceptin e ndarjes së pushteteve, pavarësinë e tyre dhe rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mes tre pushteteve, ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit, ndërsa shtoi se Kushtetuta e ka parashikuar këtë institucion, si një mekanizëm për të kontrolluar dhe mbikëqyrur punën e gjyqësorit, sa i takon shkeljeve apo abuzimeve, por pa cenuar pavarësinë e tyre në vendimmarrje.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani iu përgjigj interesimit të pjesëmarrësve për aspekte të punës ndër vite të ILD-së, por edhe për zhvillime jashtë institucionit mbi rolin dhe pritshmëritë publike.

Studentët u njohën gjithashtu me organizimin e brendshëm të institucionit, praktikën e punës dhe rëndësinë e transparencës dhe komunikimit me publikun, veçanërisht me të rinjtë dhe komunitetin akademik dhe morën përgjigje nga magjistratja gjyqtare Arjeta Lika dhe ndihmës inspektori Julis Zebi mbi mënyrën e paraqitjes e trajtimit të një ankese në ILD, të drejtat e ankuesit e magjistratit etj.



INSPEKTORI I LARTË DREJTËSISË
BULETINI MUJOR



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MORI PJESË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË RESIJ NË MADRID



Madrid, 29 maj 2026

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, mori pjesë në Asamblesë e Përgjithshme të RESIJ-it (Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit Gjyqësor), së bashku me anëtarët e tjerë, përfaqësues dhe homologë të institucioneve të inspektimit dhe sistemeve gjyqësore nga Belgjika, Bullgaria, Franca, Italia, Moldavia, Spanja, Portugalia dhe Rumania.

Aktiviteti u mikprit nga Këshilli i Përgjithshëm i Pushtetit Gjyqësor të Spanjës dhe u zhvillua në ambientet e Gjykatës së Lartë të Spanjës, në Madrid.

Në fjalët përshëndetëse në hapje të Asamblesë, kryetarja e Gjykatës së Lartë të Spanjës znj. María Isabel Perelló Doménech dhe Presidenti i RESIJ z. Stéphane Noël nënvizuan rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe vëmendjen që i duhet kushtuar standardeve të integritetit, transparencës dhe eficiencës në sistemet gjyqësore europiane.

Gjatë punimeve u diskutua mbi prioritetet dhe axhendën e ardhshme të RESIJ-it, përfshirë projektet e përbashkëta me Komisionin Evropian dhe CEPEJ (Komisioni Evropian për Eficiencën në Drejtësi në Këshillin e Evropës).

Në fokus të diskutimeve ishin gjithashtu sfidat që lidhen me procesin e digjitalizimit dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në drejtësi, studimi krahasues mbi inspektimet gjyqësore dhe mekanizmat e integritetit e të parandalimit të korrupsionit, si dhe ndryshimet statutorë dhe zgjerimi i bashkëpunimit të RESIJ-it me partnerë dhe institucione të tjera europiane.

Pjesë e diskutimeve ishte edhe bashkëpunimi ndërmjet RESIJ-it dhe ARNJIS-it (Rrjeti Arab i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë), marrëdhënie që zhvillohet prej vitesh në kuadër të bashkëpunimit me CEPEJ-in, si dhe përgatitjet për aktivitetet ndërkombëtare të planifikuara të zhvillohen në Lisbonë gjatë muajit shtator.

Në përfundim të Asamblesë, pjesëmarrësit riafirmuan rëndësinë e shkëmbimit të praktikave më të mira ndërmjet institucioneve të inspektimit gjyqësor dhe shprehën angazhimin e tyre të përbashkët për forcimin e pavarësisë, transparencës dhe eficiencës së sistemeve të drejtësisë në Europë.



ILD NË TWITTER

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Zëvendësinspektorja e Lartë e Drejtësisë, znj. Elena Pelushi mori pjesë në aktivitetin e organizuar në kuadër të Ditës së Drejtësisë 🇪🇺, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Fierit. Lexoni mesazhet që ajo përcolli gjatë këtij aktiviteti. #ILD 🇪🇺



FJALA E ZV. INSPETORESË SË LARTË TË DREJTËSISË, ZNJ. ELENA P...
From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

📍 Përpunimi javor i ankesave në #ILD

- ✅ 9145 të konfirmuara
- ✅ 6864 të trajtuara
- ✅ 2281 në proces trajtimi
- ✅ 174 në proces verifikimi
- ✅ 150 magjistratë të hetuar
- ✅ 54 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🇪🇺 🇪🇺
ild.al/sq/ankete/

9,145+	6,864	2,281	150
Confirmed Complaints	Processed Complaints	Complaints in the review process	Investigated magistrates
		174	54

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Me Ambasadorin tonë në Danimarkë 🇩🇰 Sokol Dedja, diskutuam për rëndësinë e bashkëpunimit institucional me homologët për avancimin e agjendës europiane të Shqipërisë dhe rolin e diasporës shqiptare 🇩🇰 @sokol_dedja 🇪🇺 për organizimin. #ILD 🇪🇺




Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani priti sot në takim një përfaqësi të Shoqatës së Prokurorëve të Shqipërisë. U diskutua mbi pavarësinë e prokurorëve, llogaridhënien, profesionalizmin dhe besimin publik tek drejtësia. #ILD #shoqataeprokurorëve 🇪🇺



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKON SHOQATËN E PROKUROR...
From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Me drejtorin për Politikat Evropiane në Ministrinë e Jashtme të Danimarkës Jakob K. Alvi diskutuam mbi ecurinë e reformës në drejtësi, standardet e shtetit të së drejtës, proceset integruese të Shqipërisë. Falenderues për mbështetjen e 🇩🇰 për integrimin e 🇩🇰 në BE 🇪🇺 @sokol_dedja




Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Një sesion interaktiv sot me 🇪🇺 studentët e Fakultetit të Drejtësisë 🇪🇺 në Universitetin e Tiranës mbi rolin dhe funksionet e #ILD-së, reformën në drejtësi dhe pritshmëritë e publikut. #ILD #edukimiligor #studentët #FakultetiJuridik #UniversitetiITiranës 🇪🇺



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, TAKIM ME STUDENTË TË UNIVE...
From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Shkëmbim interesant në Gjykatën Speciale për Ngritjen e Akuzës e Rishikimin, Danimarkë 🇩🇰 mbi mekanizmat danezë të inspektimit e përgjegjshmërisë së magjistratëve 🇪🇺 & praktikat reciproke për trajtimin e çështjeve disiplinore e garantimin e standardeve profesionale. #ILD @sokol_dedja






Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Show translation 🇪🇺

📍 Përpunimi javor i ankesave në #ILD 🇪🇺

- ✅ 9184 të konfirmuara
- ✅ 6891 të trajtuara
- ✅ 2293 në proces trajtimi
- ✅ 194 në proces verifikimi
- ✅ 150 magjistratë të hetuar
- ✅ 54 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? 🇪🇺 🇪🇺
ild.al/sq/ankete/

9,184+	6,891	2,293	150
Confirmed Complaints	Processed Complaints	Complaints in the review process	Investigated magistrates
		194	54

This information is updated every Monday

Thematic and Institutional Inspections

This thematic 31 | This institutional 19

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

📍 Përpunimi javor i ankesave në #ILD 🇪🇺

- ✅ 9130 të konfirmuara
- ✅ 6800 të trajtuara
- ✅ 2330 në proces trajtimi
- ✅ 167 në proces verifikimi
- ✅ 150 magjistratë të hetuar
- ✅ 54 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🇪🇺 🇪🇺
ild.al/sq/ankete/

9,130+	6,800	2,330	150
Confirmed Complaints	Processed Complaints	Complaints in the review process	Investigated magistrates
		167	54

This information is updated every Monday

MAJ 2026


Të gjitha të drejtat e rezervuara
© ILD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

KONTAKT

Web: ild.al
Tel: +35542217217
Email: info@ild.al
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)



Më skano!